



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	5
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	1724
Data Datum Date	28.07.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 28.07.2023
Nr. 5-1724

Komisioni për Licencimin e BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 2909 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga BPrAL - Kolegji "HEIMERER" dhe mori :

V E N D I M

1. Plotësohet Vendimi për Licencim nr 5/1724 i datës 16.03.2023 për BPrAL - Kolegjin "HEIMERER", me seli në Prishtinë.
2. Licencohen programet e studimeve për periudhën 1 tetor 2023 deri në përfundimin e afatit kohor të paraparë në vendimet e akreditimi nga AKA:
 - a). Infermieri (BSc). Vendimi i AKA, ref. 1361/19D dt. 29.07.2019.
 - b). Shkenca Shëndetësore për Profile Terapeutike, me specializimet: Logopedi dhe Ergoterapi (BSc). Vendimi i AKA, ref. 3034/21 dt. 12.08.2021.
 - c). Shkencat shëndetësore për Profile Diagnostike – Teknike Laboratori (BSc). Vendimi i AKA, ref. 1572/20 dt. 11.09.2020.
 - ç). Infermieri Praktika e Avancuar Infermierore (MSc). Vendimi i AKA, ref. 3034/21 dt. 12.08.2021.
 - d). Shkenca Mjekësore Laboratorike (MSc). Vendimi i AKA, ref. 3034/21 dt. 12.08.2021.
3. Programet e akredituara të paraqitura sipas shkronjës a, b, c, ç dhe d në pikën 2 të këtij vendimi, licencohen dhe fillojnë së zbatuari nga viti i ri akademik 2023/ 24 e deri në përfundim të afatit kohor të paraparë me vendimet e akreditimit.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Sipas dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2909 të datës 19.07.2023, të parashtruar nga kolegjii "HEIMERER", vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar pjesërisht kushtet dhe kriterët ligjore për licencim dhe rilicencim.

Licenca për programet e akredituara nga AKA sipas pikës dy të këtij vendimi, fillon së zbatuari nga viti i ri akademik 2023/24 dhe zgjat deri në përfundim të afatit kohor të paraparë me vendimet e akreditimit.

Kolegji "HEIMERER" në adresë të MASHTI-t – Komisionit për licencim dhe rilicencim, ka parashtruar kërkesa si në vijim : a). kërkesa nr. ref. 2453 dt. 06.06.2023 ; b). nr. ref. 2581 dt. 15.06.2023; c). nr. ref. 2697 dt. 27.06.2023; ç). nr. ref. 2909 dt. 19.07.2023 duke potencuar faktin se pas marrjes së licencës nr. ref. 6-606 e datës 06.07.2020 ka akredituar nga AKA me vendimet përkatëse programet e cekura sipas pikës dy të dispozitivit të këtij vendimi, por që nuk janë përfshirë në vendimin për licencim nr. 5/1724 datë 16.03.2023.

Nga "pakujdesia" apo " mos leximi i drejtë " i Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037 i datës 29 gusht 2011– sipas nenit 14, konkretisht paragrafit 6 dhe 7 si dhe Udhëzimit administrativ nr. 25/ 2012 i datës 22.10.2012, konkretisht nenit 6 paragrafit 3 të këtij Udhëzimi, zyrtarët përgjegjës të këtij institucioni nuk e kanë proceduar me kohë reale kërkesën e nevojshme në adresë të komisionit për licencim dhe rilicencim në mënyrë që programet e akredituara të zyrtarizoheshin përmes një vendimi apo shkrese tjetër zyrtare që do ta lëshonte ky komision. Për këtë arsye, komisioni për licencim i MASHTI-t, në një përgjigje me shkrim nr. ref. 2533 e datës 13.06.2023 e ka refuzuar kërkesën e kolegjii "HEIMERER" nr. 356 dt. 08.02.2023, pasi kërkesa kishte të bënte me njohjen e programeve të akredituara nga AKA si plotëni, pra nga koha e akreditimit e deri me tani dhe me përfundimin kohor të tyre të paraqitura në vendimet gjegjëse.

Ndërkaq, në kërkesat e mëvonshme, konkretisht sipas kërkesës nr. ref. 2697 e datës 27.06.2023 drejtuar komisionit për licencim dhe rilicencim citojmë : **" Lusim komisionin për licencim që të marrë parasysh vendimet e AKA bashkangjitur me këtë shkresë në mënyrë që në vendimin me nr. 5/1724 të përfshihen të gjitha programet që aktualisht kanë akreditim nga momenti i hyrjes në fuqi të licencës e deri në përfundim të licencës, pra nga 2023 deri në përfundim të licencës" si dhe kërkesës nr. 2909 dt. 19.07. 2023, me po të njejtën përmbajtje komisioni e merr si të bazuar kërkesën dhe me këtë vendim ia njeh dhe licencon programet e akredituara nga AKA, duke e pranuar si të arsyeshme kërkesën pasi që licencimi është kërkuar nga institucioni në fjalë për periudhën kohore të vitit të ri akademik 2023/24 e deri në skadimin e tyre të parapara me vendimet përkatëse.**

Komisioni për licencim dhe rilicencim i MASHTI-t, nuk ka gjetë bazë ligjore që institucionit në fjalë – Kolegjit "HEIMERER" t'ia njeh retroaktiv programet e akredituara nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës për periudhën që ka punuar pa licencë përkatëse ku do të ishin përfshirë edhe programet e akredituara më vonë, gjegjësisht programet që nuk ishin të përfshira as në vendimin e vitit 2020 dhe as në vendimin e vitit 2023.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në kërkesën/ at me shkrim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te komisioni për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës – Kolegjit “HEIMERER”;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. DALSHITI;
4. Komisionit për Licencim;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit


Burim Gashi

